



DEKLARATË MBI BASHKËPUNIMIN E MËTEJSHËM

NDËRMJET AGJENCIONIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, REPUBLIKA E MALIT TË ZI
DHE

AGJENCIONIT SHETETËROR PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, REPUBLIKA E KOSOVËS

Agjencioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Malit të Zi dhe Agjencioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës dëshirojnë të bëjnë deklaratë të përbashkët duke afirmuar bashkëpunimin e tanishëm dhe gatishmërinë e tyre për të vazhduar bashkëpunimin reciprok.

Ky bashkëpunim është për të përmirësuar shkëmbimin e përvojave më të mira praktike dhe njohurive midis ekspertëve të të dy Institucioneve në lidhje me fushat në vijim:

- Zhvillimin Legjislativ
- Bashkëpunimin me akterë ndërkombëtarë, me qëllim të arritjes së një zgjidhjeje të harmonizuar të problemeve të ndryshme
- Shkëmbimin e përvojës në fushën e zhvillimeve të reja teknologjike
- Projektet e themeluara nga Bashkimi Evropian
- Barta e të dhënave personale

Të dy Institucionet janë të vetëdijshme për nevojën e pashmangshme për të rritur bashkëpunimin midis autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave, me qëllim të krijimit të një aplikimi të qëndrueshëm të legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave ekzistues në vende të ndryshme.

Institucionet e poshtëshënuara në frymën e mirë të kësaj Deklarate, në përputhje me gatishmërinë e tyre do të bëjnë vizita të ndërsjella në fushën e shkëmbimit të përvojave dhe zgjerimit të bashkëpunimit.

Është mendim i të dy autoriteteve që kjo do rezultojë në bashkëpunim më të mirë, dhe shkëmbim të informacioneve ndërmjet tyre dhe përfundimisht, në mbrojtje më të madhe të të dhënave të qytetarëve.

për Agjencionin Shtetëror për
Mbrojtjen e të Dhënave Personale
të Republikës së Malit të Zi

për Agjencionin Shtetëror për
Mbrojtjen e të Dhënave Personale
të Republikës së Kosovës

Z. Šefko CRNOVRŠANIN

Z. Ruzhdi JASHARI